

## **LUAN DUZHA**



**Datëlindja:** 25.11.1966

**Vendlindja:** Cërrik

**Email:** Luan.Duzha@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Z. Luan Duzha ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë për Financë-Kontabilitet në vitin 1989.

Ai ka mbajtur poste të ndryshme drejtuese. Menjëherë pas përfundimit të studimeve ka punuar si shef finance në Repartin Ushtarak nr. 2002 në Elbasan, për një periudhë dy vjeçare. Në vitin 1991 deri në 1993 ka punuar si shef finance në Rajonin Hekurudhor Elbasan.

Për një periudhë kohore ai ka qenë i punësuar në sektorin privat 1993-1995 dhe më vonë si përgjegjës sektori në fondacionin “Xhaferri” pranë BKT Elbasan.

Në vitet 1995-1996 ka ushtruar detyrën e shefit të financës në Bashkinë Cërrik. Gjatë periudhës 2000-2005 ka ushtruar detyrën e nëndrejtorit ekonomik në qendrën spitalore “Xhaferr Kongoli”.

Në vitet 2006-2010 , z. Duzha ka patur detyrën e drejtorit të Uzinës së Lëndëve Plasëse në qytetin e Elbasanit dhe në 2010 deri në 2013 ka drejtuar Shërbimin Pyjor të Elbasanit.

Z. Luan Duzha ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë që prej vitit 2013, në legjislaturat VIII dhe IX dhe është rimandatur për herë të tretë si deputet i Kuvendit të Shqipërisë në zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në vitin 2021.